



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



Nr. 5624/1 Prot

15.10.21

Nr. 661/1 Prot.

Shkodër, më 12.10.2021

Lënda: Mbi Vendimin nr. 58, datë 27.09.2021 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, është depozituar për shqyrtim *VKB Vau Dejës nr. 58, datë 27.09.2021 “Për miratimin e rinovimit të kontratës së subjektit ‘Albtelekom’ SH.A. për antenën e transmetimit të telefonisë celulare”, në ekonominë pyjore Bushat Bërdicë, ngastra 15b, me sipërfaqe 0.03 ha dhe rrugë kalimi 0.311 km, sipas shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 5144 prot., datë 01.09.2021 “Dokumentacioni shoqërues i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës të datës 26.08.2021”.*

Referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të VKM nr. 391, dt. 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, pika 22/g, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm, pasi është në tagrin e këshillit bashkiak të japë në përdorim prona me qëllim nxjerrjen e të ardhurave, e drejtë e cila ushtrohet vetëm nga këshilli, në cilësinë e organit kolegjal.

Lidhja apo nënshkrimi i kontratës në zbatim të nenit 9 pika 1.6/a dhe nenit 64/gj të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, është tagër i Kryetarit të Bashkisë.

Elementi i rinovimit¹ të kontratës mund të aplikohet nëse ka qenë pjesë përbëse e kontratës dypalëshe me të njëjtin subjekt dhe ky operator i ka plotësuar të gjitha detyrimet që ka patur ndaj bashkisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI



¹ Tregoni vëmendje në terminologjinë e cituar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

Nr. _____ prot.

Vau Dejës, më ____ . ____ .2021

V E N D I M

Nr. 58, datë 27.09.2021

**PËR MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATËS SE SUBJEKTIT “ ALBTELECOM”
SH.A PËR ANTENËN E TRANSMETIMIT TË TELEFONISE CELULARE.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës **27.09.2021**, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e1”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 25 pika 1, e ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet” ,pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016,i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” ,si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.7.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkitimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” **me shumicë të cilësuar votash.**

V E N D O S I

1. Miratimin e rinovimit të kontratës së subjektit “ALBtelekom Sh.a ” për antenë të telefonise celulare në ngastrën nr .15b, ekonomia pyjore Bushat Berdicë me sipërfaqe 0.03 ha si dhe rrugë kalimi me gjatësi 0.311 km.
2. Afati i dhënies me qera të jetë 5 vjekar me të drejtë rinovimi.
3. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti duke rigjeneruar te ardhura , sigurohen të ardhura tek Bashkia të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas studimit tekniko-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM nr. 1064, dt. 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.
5. Ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Rural, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 04.102021